



Republika e Kosovës

Republika Kosovo / Republic of Kosovo



Kuvendi i Komunës Rahovec

Skupština Opštine Orahovac / Municipal Assembly Rahovec

Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor

**KOMITETI PËR PERSONA ME AFTËSI TË KUFIZUARA  
P R O C E S V E R B A L**

Mbledhja e parë e Komitetit për Persona me Aftësi të Kufizuara, e mbajtur sot, më datë 25.03.2026 (e mërkurë), me fillim në ora 10:00. Mbledhjen e kryesoi kryesuesja e komitetit, Samra Kërçagu. Të gjithë anëtarët e komitetit ishin të pranishëm në mbledhje.

Për këtë mbledhje është propozuar ky:

**R E N D I T E**

REPUBLICA E KOSOVES / REPUBLIKA E KOSOVO  
KUVENDI I KOMUNES / SKUPSTINA OPSTINE / MUNICIPAL ASSEMBLY

RAHOVEC / ORAHOVAC

Njësia Nr./Br./No 01 (Kuvendi i Komunës)

Nr./Br./No 01/141 Nr. i faq./Br.str/No.pg 07

Data/Datum/Date 29.03.2026

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;
2. Zgjedhja e zëvendëskryesuesit/es të Komitetit Konsultativ për Persona me Aftësi të Kufizuara;
3. Shqyrtimi dhe miratimi i Planit të Punës për vitin 2026;
4. Të ndryshme.

**Kryesuesja:** Mirëmëngjesi! Përshëndetje për të gjithë! Jemi mbledhur sot, për ta mbajtur edhe takimin e parë të Komitetit për Persona me Aftësi të Kufizuara për vitin 2026. Vazhdojmë me leximin e rendit të ditës. Atëherë, rendin e ditës si të tillë e vendosim në votim! Kush është “pro”?... Unanimisht aprovohet rendi i ditës.

**1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar:**

**Kryesuesja:** Atëherë, nëse dikush ka ndonjë vërejtje rreth procesverbalit nga mbledhja e kaluar? Nëse jo, e vendosim në votim. Kush është pro? Unanimisht aprovohet edhe procesverbali i mbledhjes së kaluar.

**2. Zgjedhja e zëvendëskryesuesit/es të Komitetit Konsultativ për Persona me Aftësi të Kufizuara:**

**Adelinë Shabandula:** Faleminderit, kryesuese! Atëherë, për zëvendëskryesues unë e propozoj, Ferat Durgutin.

**Kryesuesja:** Nëse dikush tjetër nuk ka propozim, në votim po e vendosim propozimin e Adelinës. Kush është “për”?... Atëherë, unanimisht Ferat Durguti zgjedhet zëvendëskryesues i Komitetit Konsultativ për Persona me Aftësi të Kufizuara. Urime Ferat, të ftoj të ulesh këtu lart.

**3. Shqyrtimi dhe miratimi i Planit të Punës për vitin 2026:**

**Kryesuesja:** Plani i punës për vitin 2026 është gati, por nëse dikush dëshiron ta ndajë ndonjë ide tjetër, patjetër që do ta vendosim në plan. Shembull mund të jetë si të organizohemi më 3 dhjetor, me ndonjë tryezë apo me aktivitete në palestër?! Nëse nuk ka ide të tjera, këtë plan e vendosim në votim. Kush është “për”?... Unanimisht aprovohet edhe plani i punës për vitin 2026.

**4. Të ndryshme:**

**Selman Shtavica:** Përshëndetje! E kam një vërejtje për këtë komitet. Nuk jemi shumë aktivë. Mendoj që duhet ta rrisim kontributin, sepse kjo kategori ka nevojë për përkrahjen tonë. Duhet të luftojmë duke e ngritur zërin edhe për punësim të kësaj kategorie.

**Kryesuesja:** E kemi të përfshirë në plan të punës këtë ide. Në muajin shtator e kemi të titulluar: Punësimi dhe mbështetja sociale.

**Selman Shtavica:** Një problem tjetër që dua ta cekim është problemi i pengesave infrastrukturore. P.sh: Në banka nuk ka barela të karrocave, ka vetëm në NLB, por pa standarde.

**Ferat Durguti:** Përshëndetje! Sa i përket kësaj çështjeje, mund ta bëjmë një evidentim dhe si komitet mund t'ju drejtohem bankave me një kërkesë që sipas mundësive t'i realizojnë këto lehtësira për persona me aftësi të kufizuara (rampë për qasje).

**Kryesuesja:** Ne duhet t'i kuptojmë kompetencat tona. Nuk kemi kompetencë ekzekutive, por si komitet mund vetëm të sugjerojmë.

**Sead Rama:** Përshëndetje për të gjithë! Ju, si komitet mund të bëni rekomandime, por gjithnjë pasi t'i bëni të gjeturat e nevojshme. Shfrytëzoheni ditën ndërkombëtare, 3 nëntorin, ku mund të loboni me rekomandime nëpër institucione, për të gjitha çështjet që paraprakisht i keni mbledhur të dhënat.

**Kryesuesja:** Faleminderit për kontributin! Nëse edhe dikush tjetër nuk ka diçka për të shtuar, atëherë po e përfundojmë mbledhjen e parë. Shihemi në mbledhjen e radhës.

Procesmbajtësi

  
Albion Krasniqi



Kryesuesja e komitetit

  
Samra Kërçagu